



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Sh II.nr.1670/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha në çështjen përmbartimore të kreditorit “Agron Commerce” SHPK, me NUI:810364216, me adresë “Zona Industriale”, Komuna Mitrovicë, kundër debitorit “Trepça” SH.A. me NUI:811278747 me adresë “Parku Industrial”, Komuna Mitrovicë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.1879/23 të datës 29.05.2024, me datë 14.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet ankesa e debitorit Trepça SH.A me seli në Mitrovicë, Prishtet aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1879/23 i datës 29.05.2024, dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1879/23 të datës 29.05.2024 ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar propësimin e debitorit “Trepça” SH.A me seli në Mitrovicë, ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.261/23, i lejuar me datë 30.10.2023, nga Përmbartuesi Privat IImi Miftaraj dhe i njëjti urdhër Përmbartimor P.nr.261/23, i lejuar me datë 31.10.2023 mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës përmbare, me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anulohet aktvendimi i Komerciale Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr. 1879/23 të datës 29.05.2024.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Agron Commerce” SHPK, ka paraqitur propozim për përmbare ndaj debitorit Trepça SH.A me seli në Mitrovicë, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, faturës Nr.52/2023 të datës 08.09.2023 dhe nr.61 datës 28.09.2023.

Përmbaresi privat Ilmi Miftaraj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka nxjerr urdhrin përmbare P.nr.261/2023 dt.30.10.2023, me të cilin ka detyruar debitorin që në nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 28,147.26.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga kur është dashur të paguhet fatura, si dhe shpenzimet e procedurës përmbare, nën kërcënim të përmbaremit të dhunshëm.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, me të cilin e ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke lënë në fuqi urdhrin përmbare P.nr. P.nr. 261/23, i lejuar me datë 31.10.2023 të Përmbaresit Privat.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se në rastin konkret Fatura Nr. 52/2023 të datës 08.09.2023, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbare, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm, i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përmbare, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbaremi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë

të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Dhe duke u bazuar në të lartcekurat, shkalla e parë lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar, tani për tani nuk e përkrah Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, për faktin se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës, si dhe ankesës së debitorit, ka gjetur se aktvendimi i ankimuar është marrë me vërtetim jo të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Po ashtu kjo gjykatë ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 të LPK-së, dhe neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 38 të LPP-së, për çka kjo gjykatë vendosi që ky aktvendim të anulohet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së ekziston për faktin se në shkresat e lëndës gjendet transaksioni bankar NLB Bank i dates 28.12.2023 si dëshmi se debitori ka bërë pagesë kreditorit, sipas tri faturave nr.18/23, 52 dhe 61 në vlerë të përgjithshme prej 38,758.66€ dhe kartela e klientit e lëshuar nga kreditori per periudhen 01.01.2023-31.12.2023, dokumente këto të cilat kanë ekzistuar gjatë procedurës përmbartimore, mirëpo nuk është e qartë pse në asnjë rast këto dokumente nuk janë vlersuar dhe paraqitur si prova nga palët ndërgjyqëse gjatë procedurës përmbartimore dhe në gjykatën e shkallës së parë, përveq se tani me ankes debitori paraqet këto pretendime ankimore me arsyetimin se borxhi i është shlyer

kreditorit përmes transferit bankar. Arsye këto të cilat bëjnë që vendimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje dhe rishqyrtim në shkallë të parë.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t'i ketë parasysh shkeljet e sipërcituara dhe t'i evitoj ato, të ndërmer veprime përkatëse të nevojshme, sipas nevojës të ftohen palët ndërgjyqëse dhe të caktohet seancë dëgjimore, përmes të cilave do ta sqaroj dhe vlerësoj urdhrin përmbarrimor, përshtatshmërinë e dokumenteve të besueshme, ta shqyrtojë se të njejtat a i plotësojnë kushtet ligjore për përmbarrim, e pas kësaj gjykata të merr një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në mbështetje të nenit 208 dhe 209 pika (d) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K. DH.Sh II.nr.1670/24 me datë 14.01.2025

Gjyqtari,
Krenar Berisha